Kronikë

Arrestohet në Vlorë me armë farmacisti i spitalit të Traumës! Ish-komandos së ushtrisë iu gjetën këllëfë pistolete e veshje kamuflazhi (VIDEO)

Enron Sejdini, 38 vjeç, ish-komando dhe aktualisht farmacist në spitalin e traumës, u arrestua me armë pa leje në Vlorë. I riu sapo kishte mbërritur në qytet, kur policia ka ndërhyrë duke i vënë prangat në rrugën "Hajro Çakërri". Burime të policisë, i thanë Report Tv se i riu dyshohet se ka lidhje me një prej grupeve kriminale në këtë qytet.

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

[Sh.com] Redaksia
5 Tetor, 09:20 | **Përditësimi: 5 Tetor, 15:31**

Share

VLORË- Një ish-komando i ushtrisë shqiptare, 38-vjeçar, aktualisht farmacist në Spitalin e Traumës, u arrestua nga policia e Vlorës pasi lëvizte në qytet i armatosur. I riu Enron Sejdini u kap në flagrancë me një pistoletë "Bereta" dhe një krehër me fishekë teksa ishte duke lëvizur në këmbë në rrugën "Hajro Çakërri". Policia kishte marrë më herët informacione se Sejdini, i cili banonte dhe punonte farmacist në Tiranë dhe me origjinë nga Fieri, sapo kishte ardhur në Vlorë i armatosur dhe organizoi punën për kapjen e tij.

Report Tv mëson se 38-vjeçari Enron Sejdini ka qenë me herët pjesë e forcave "komando", por është larguar nga shërbimi prej disa vitesh. Të njëjtat burime bëjnë me dije se i riu dyshohet se shoqërohej me njërin prej grupeve kriminale që bazën e ka në qytetin bregdetar ku edhe u arrestua. Mbetet e paqartë arsyeja që ai ka shkuar i armatosur në Vlorë, por burimet thonë se po hetohet në këtë drejtim nëse do kryente ndonjë vepër penale.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
Selenicë/ Vijon prej mbrëmjes së djeshme zjarri në parcelat me ullinj në Dushkarak, banorët: Njoftuam zjarrfikësen, por s'ka ardhur

Paralelisht me operacionin në Vlorë, policia në Tiranë kreu kontroll në banesën e ish-ushtaraku në rrugën "Kongresi i Lushnjës", pranë zonës së "21 Dhjetorit", ku gjeti dhe sekuestroi edhe 2 këllëfë pistolete dhe veshje kamuflazhi, si ato të ushtrisë. Nuk dihet nëse këto veshje ishin me qëllim përdorimi për aktivitete kriminale, apo të mbetura që prej kohës që ai ka qenë pjesë e forcave "komando". Ndaj 38-vjeçarit është formuluar akuza "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit".

M.T/G.MO/Shqiptarja.com

TAG: Vlore | arme | policia vlore | Erion Sejdini

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.com

Sondazhi i ditës:
Kush ka mbajtur qëndrimin më të saktë rreth situatës në veri të Kosovës?

Rama | Kurti | Nuk e di

Lajme të tjera

Goditi me grusht punonjësin e qarkullimit rrugor, vihet në pranga 27-vjeçari në Vlorë
5 Tetor, 14:22

EMRI/ Armë dhe municion të fshehura në banesë, arrestohet 54-vjeçari në Durrës! Sekuestrohen 1 kallashnikov dhe 182 fishekë
5 Tetor, 12:57

Asgjësohen 244 bimë narkotike në Himarë! Vihen nën hetim kryeplaku dhe punonjësi i shërbimit pyjor në Shënvasil
4 Tetor, 16:25

500 raste në javë, rritet numri i virozave stinore në Vlorë! Mjeku Bashllari: Vaksinim anti-grip, shqetësim edhe Covid

Armand Xhelili

4 Tetor, 15:18

EMRAT/ Ndezën zjarr në tokat e tyre, por flakët dolën jashtë kontrollit! Vihen në pranga dy 'piromanët' në Himarë (VIDEO)
4 Tetor, 09:20

Konispol, shiste ushqime të skaduara në dyqanin e shkollës, në pranga polici i bashkisë
3 Tetor, 10:56

VIDEO/ RENEA e Operacionalet 'mësyjnë' sërish Vlorën,14 të shoqëruar! Bllokohet dhe një makinë e blinduar e dy luksoze
2 Tetor, 21:58

Vlorë/ Mjeti tip 'Range Rover' godet makinën e policisë nga pas, plagoset efektivi dhe mekaniku
2 Tetor, 13:55

Në Vlorë, nuk regjistrohet asnjë student për degët Kimi, Matematikë, Fizikë e Gjuhë italianë
2 Tetor, 11:40

'112' - Ekskluzive/ 'Tempulli', pamjet hap pas hapi të arrestimeve të shpërndaresve të drogës pranë shkollave
1 Tetor, 21:01

Makina del nga rruga në aksin rrugor Vlorë-Kuç, lëndohet pasagjerja
1 Tetor, 19:30



FNSH zbarkon në Vlorë, kryen kontrolle për persona që lëvizin me armë apo të shpallur në kërkim
30 Shtator, 19:04

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje